



BASHKIA BERAT



**TAKSAT DHE TARIEMAT VENDORE
2017**

A. TAKSAT VENDORE**1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL**

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin vogël.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, për Bashkinë Berat përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË	Shkalla Tatimore
I. Për tatimpaguesit me qarkullim nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë në vit	0 (zero)
II. Për tatimpaguesit me qarkullim nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë në vit	5 (pesë) %

Afatet e pagesës

- Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë dhe/ose Posta Shqiptare për llogari të administratës tatimore brënda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti.
- Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit. Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.
- Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkise, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet.

2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen :

1. Taksa mbi ndërtesat,
2. Taksa mbi tokën bujqësore,
3. Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike)

2.a TAKSA MBI NDËRTESAT

Nivelet e taksës mbi ndërtesat sipas kategorive dhe nënkategorive përcaktohen sipas tabelës së mëposhtme :

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otlak	Velabisht
	Lek/m ² /vit				
I. NDËRTESTA BANIMI					
a. Për shtëpinë ku tatimpaguesi ka banimin e zakonshëm					
- Ndërtuar para vitit 1993	10	5	5	5	5
- Ndërtuar gjate dhe pas vitit 1993	12	6	6	6	6
b. Për të gjitha shtëpitë e tjera të tatimpaguesit					
- Ndërtuar para vitit 1993	20	10	10	10	10
- Ndërtuar gjate dhe pas vitit 1993	24	12	12	12	12
II. NDËRTESTA TË TJERA					
a. Ndërtesa të subjekteve me aktivitet “tregti me pakicë/ shumicë”, “shërbime”, “profesione të lira”, “import-eksport”	255	150	150	150	150
b. Ndërtesa të subjekteve me aktivitet “ndërtim”	210	150	150	150	150
c. Ndërtesa të subjekteve me akti- vitet “prodhim”	165	75	75	75	75
d. Për sipërfaqe (veranda) që shfrytëzohen në pranverë dhe verë	157.5	90	90	90	90
III. TË TJERA					
a. Objekte të ish ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet tregtar etj.	66	30	30	30	30
IV. NDËRTESTA NË PRONËSI APO NË PËRDORIM NË TERRITORE TË MIRATUARA SI FSHATRA TURISTIKË					
Taksa	400	200	200	200	200

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi.

Në rast të mungesës të dokumentit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës.

- Familjet dhe bizneset në fshatrat Roshnik, Mbreshtan, Otlak dhe Velabisht paguajnë 10% shtesë të taksës mbi ndërtesat
- Taksa mbi ndërtesat për kategorinë I **"Ndërtesa Banimi"** (nga familjet) paguhet për cdo ndërtesë që qytetari ka në pronësi.
- Taksa mbi ndërtesat për kategorinë II **"Ndërtesa të tjera"** dhe kategorinë III **"Të tjera"**, paguhet për cdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitet.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së pasurisë mbi ndërtesat është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, në Bashkinë Berat.
- Për subjektet që kanë sipërfaqe (veranda) që shfrytëzohen në sezonet e pranverës dhe verës taksa e pasurisë mbi ndërtesat paguhet nga fillimi i sezonit deri në mbarim të sezonit.

Afatet e pagesës

- Për kategorinë II **“Ndërtesa të tjera”** dhe kategorinë III **“Të tjera”** :
 - Për sipërfaqe < 2,000 m² detyrimi paguhet me një kësht të vetëm, brenda datës 20 Prill.
 - Për sipërfaqe ≥ 2,000 m² detyrimi paguhet me dy kështe të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill dhe kësti i dytë paguhet brenda datës 20 Korrik.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, pezullon veprimtarinë ose aplikon për cregjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet proporcionalisht, duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose cregjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Lehtësirat tatimore

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi ndërtesat:

- Taksapaguesit, për kategorinë I **“Ndërtesa banimi”** dhe që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës” si dhe të sëmurë para dhe tetraplegjikë. Kjo zbatohet në rastet kur taksapaguesi nuk merret me aktivitet biznesi.
- Pronat e shtetit dhe të njëjve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse,
- Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrës me qira të paliberalizuara,
- Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.
- Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.

2.b TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Niveli i kësaj takse për sipërfaqet e tokës bujqësore sipas kategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

Kategoria e tokës bujqësore	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otlak	Velabisht
	Lek/ha/vit				
III				2 800	
IV				2 300	2 300
V			1 900	1 900	1 900
VI		1 600	1 600	1 600	1 600
VII	1 400	1 400	1 400	1 400	1 400

- Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi. Në rast të mungesës të dokumentit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore.
- Familjet dhe bizneset në fshatrat Roshnik, Mbreshtan, Otlak dhe Velabisht paguajnë 10% shtesë të taksës mbi tokën bujqësore.
- Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor.
- Për njësinë administrative Roshnik, në kategorinë e VI të tokës bujqësore përfshihen tokat në fshatrat Roshnik, Roshnik i Vogël, Vojnik, Mimias, Bogdan 1 Karkanjok, Rabiak. Në kategorinë e VII të tokës bujqësore përfshihen tokat në fshatrat Kostren 1, Kostren 2, Dardhë, Qafë Dardhë, Perisnakë, Bogdan 2.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve në Bashkinë Berat.

Lehtësirat tatimore

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi tokën bujqësore:

- Taksapaguesit që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës” si dhe invalidet para dhe tetraplegjikë. Ky përjashtim zbatohet kur taksapaguesi nuk merret me aktivitet biznesi.
- Sipërfaqet e tokës bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes (e konfirmuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit Berat).

2.c TAKSA MBI TRUALLIN

Niveli i taksës mbi truallin (jo hapësirë publike) përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

KATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otlak	Velabisht
	Lek/m ² /vit				
I. Për truallin që përdoret për qëllime banimi nga individët	0.42	0.3	0.3	0.3	0.3
II .Për truallin që përdoret për qëllime biznesi	18	13	13	13	13

Me “Truall” kuptohet një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brënda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjorë të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

- Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

- Familjet dhe bizneset në fshatrat Roshnik, Mbreshtan, Otlak dhe Velabisht paguajnë 10% shtesë të taksës mbi truallin.
- Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor.

- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, ne Bashkine Berat.

Lehtësirat tatimore

Përrjashtohen nga pagimi i taksës mbi truallin taksapaguesit që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës” si invalidet para dhe tetraplegjikë. Ky përjashtim zbatohet kur taksapaguesi nuk merret me aktivitet biznesi.

3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Niveli i taksës së fjetjes në hotel sipas kategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

KATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otlak	Velabisht
	Lek/për natë fjetje/person				
I. Hotel me 4-5 yje	175	122.5	122.5	122.5	122.5
II. Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduuese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	70	49	49	49	49

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të fjetjes në hotel, për person.

- Me “Hotel” kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, ne Bashkine Berat.

Afatet e pagesës

- Detyrimi për taksën e fjetjes në hotel paguhet brënda datës 5 të muajit pasardhës.

4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, për Bashkinë Berat sipas kategorive dhe nënkategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Niveli i taksës
I. Për qëllime banimi dhe njësi shërbimi	
a. Me destinacion banim	5 % e çmimit të shitjes për m ²
b. Me destinacion garazhd	4 % e çmimit të shitjes për m ²
c. Me destinacion njësi shërbimi (lokale, dyqane etj...)	6 % e çmimit të shitjes për m ²
II. Për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik	
a. Me destinacion banim (banesa sociale)	2 % e vlerës së investimit
b. Me destinacion në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik	3% e vlerës së investimit
III. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0,1% e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit
IV. Për ndërtesat që janë në proces legalizimi	0.5% e vlerës së investimit

- Baza e taksës së ndikimit në infrastrukturë është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për m² të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
- Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të tregut sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.
- Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për m².
- Detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë i takon investitorit.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për kategorinë I **“Për ndërtesa banimi”**, kategorinë II **“Për ndërtesa të tjera (biznes, tregti, shërbim, prodhim etj)”** dhe kategorinë III **“Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte”** është Drejtoria e Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve, ndërsa për kategorinë IV **“Për ndërtesat që janë në proces legalizimi”**, agjent tatimor për vjeljen e kësaj takse është A.L.U.I.Z.N.I Berat.

Afatet e pagesës

Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë do të bëhet para marrjes së lejes së ndërtimit. Në rast se subjekti nuk bën pagesën brenda një muaji nga data e zbardhjes së lejes së ndërtimit atëherë shfuqizohet leja e ndërtimit për këtë objekt.

5. TAKSA E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Niveli i taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme sipas kategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

KATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otllak	Velabisht
	Lek/m ²				
I. Ndërtesa banimi	300	100	100	100	100
II. Ndërtesa për tregti të jashtme	700	300	300	300	300
III. Ndërtesa të tjera	500	200	200	200	200

- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.
- Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.
- Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të

paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind.

- Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;perjashtohen nga kjo takse.
- Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Berat e cila përfton 3% të shumës së arkëtuar.

Afatet e pagesës

- Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Të ardhurat nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit të Bashkisë Berat në territorin e së cilës ndodhet pasuria, brenda dates 30 te muajit pasardhës.

6. TAKSA E TABELËS

Niveli i taksës së tabelës sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otlak	Velabisht
	Niveli i taksës				
I. Tabelë për qëllime identifikimi					
a. Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 m², të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brënda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. (leke/vit)	0	0	0	0	0
a/1. Tabelë për qëllime identifikimi, mbi 2 m², të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brënda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. (lekë/m²/vit)	45 000	31 500	31 500	31 500	31 500
b. Tabelë për qëllime identifikimi, jashtë territorit ku zhvillohet aktivitet në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim (Lek/vit)	120	120	120	120	120

II. Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme					
a. Tabelë e thjeshtë (lekë/m ² /vit)	22 500	15 750	15 750	15 750	15 750
b. Tabelë elektronike (lekë/m ² /vit)	45 000	31 500	31 500	31 500	31 500
III. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj					
Taksa (Lek/m ² /ditë)	1 000	700	700	700	700

- Për kategorinë I **“Tabelë për qëllime identifikimi”**, vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet tregtare dhe institucionet shtetërore.
- Për kategorinë I **“Tabelë për qëllime identifikimi”**, dhe kategorinë II **“Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme”**, të cilat vendosen në hapësirën publike para vendosjen se saj cdo subjekt duhet të kryej këto procedura :
 - Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve, ne Bashkinë Berat.
 - Paraqitja e planvendosjes.
 - Marrja e miratimit nga Këshilli Teknik i KRRT – së.
 - Pagesa e lejes për vendosjen e reklamës.
 - Lidhja e kontratës dhe pagesa e taksës së tabelës për qëllime reklamimi.
- Për kategorinë III **“Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj”**, detyrimi për taksën e tabelës llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen e lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Berat.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, ne Bashkinë Berat.

Afatet e pagesës

- Taksa e tabelës paguhet për cdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin si dhe për cdo tabelë të vendosur.
- Detyrimi për taksën e tabelës paguhet me një kësht të vetëm, brënda datës 20 Prill.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brënda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, pezullon veprimtarinë ose aplikon për cregjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet proporcionalisht, duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose cregjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

II. TARIFAT VENDORE

1. TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE

Niveli i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otlak	Velabisht
	Lek/vit				
I. FAMILIARËT					
a. Për cdo familje	1 300	1 200		500	500
b. Me status invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, invalide para dhe tetraplegjikë, ish të dënuar dhe të përndjekur politikë si dhe familje me një pjestar	650	600		250	250
II. SUBJEKTE TË BIZNESIT TË VOGËL					
a. Ambulantë	2 500	2 000	2 000	1 000	1 000
b. Shërbime, transport pasagjerësh dhe mallrash	7 000			6 000	4 000
c. Bar kafe, tregti me pakicë/shumicë, ushqimore, profesione të lira	15 000			12 000	6 000
d. Prodhim	16 000			15 000	7 000
e. Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	17 000			13 000	8 000
III. SUBJEKTE TË BIZNESIT TË MADH					
a. Transport pasagjerësh dhe mallrash	7 000	20 000	30 000	6 000	4 000
b. Profesione të lira, shërbime, tregti me pakicë/shumicë, import – eksport etj...	40 000			20 000	15 000
c. Prodhim	69 000			40 000	40 000
d. Ndërtim	80 500			60,000	60,000
e. Per subjekte që nxjerrin gurin ranor ne cdo njësi administrative		80 000	80 000	80 000	80 000
IV. INSTITUCIONE SHETËTËRORE					
a. Për cdo institucion shtetëror me numër të punësuarish ≤ 30 vetë	25 000				
b. Për cdo institucion shtetëror me numër të punësuarish > 30 vetë	50 000				

- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë I **“Familjarët”**, paguhet një herë në vit nga cdo familje.
- Për njësinë administrative Roshnik, tarifa paguhet nga familjet dhe bizneset në fshatin Roshnik.
- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”** dhe kategorinë III **“Subjektet të biznesit të madh”**, paguhet për cdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitet.
- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë IV **“Për institucionet shtetërore”**, paguhet një herë në vit nga cdo institucion.
- Për njësinë administrative Berat, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë I **“Familjarët”** ; është

agjenti tatimor “Ujësjellës Kanalizime Berat – Kucovë Sh.a” për abonentët e vet. Për joabonentët e agjentit tatimor si dhe për vjeljen e detyrimeve të prapambetura të para vitit 2013 struktura e ngarkuar është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve Lek/m2/ditë

- Për njësit administrative Roshnik, Sinjë, Otlak, Velabisht struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, ne Bashkine Berat.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”**, kategorinë III **“Subjektet të biznesit të madh”** dhe për kategorinë IV **“Institucione shtetërore”**, është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, ne Bashkine Berat.

Afatet e pagesës

- Për kategorinë I **“Familiarët”**, për abonentët e agjentit tatimor “Ujësjellës Kanalizime Berat – Kuçovë Sh.a, detyrimi vjetor paguhet me 12 këste mujorë.
- Për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”** dhe kategorinë III **“Subjektet të biznesit të madh”**, detyrimi paguhet me një këst të vetëm, i cili paguhet brenda datës 20 Prill.
- Për kategorinë IV **“Institucione shtetërore”** detyrimi paguhet me një këst të vetëm, i cili paguhet brenda datës 30 Qershor.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, pezullon veprimtarinë ose aplikon për cregjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet proporcionalisht duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose cregjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Lehtësirat tatimore

- Tarifëpaguesit e kategorisë I **“Familiarët”** dhe që i përkasin kategorive me status **“Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, invalidë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë”** si dhe familjet me një pjestarë, paguajnë 50 % të tarifës normale të pastrimit dhe largimit të mbeturinave. Kjo zbatohet kur asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.
- Për njësinë administrative Berat, në zbatim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe Fondacionit Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim, të miratuar në parim me V.K.M nr. 918 datë 04.10.2013, tarifa e pastrimit që do mblidhet nga subjektet e biznesit që ushtrojnë aktivitet në Zonën për Zhvillimin e Biznesit (BID) do ti transferohet shoqatës së bizneseve të zonës BID.
- Tarifëpaguesit e kategorisë IV **“Institucione shtetërore”** me numër të punësuarish ≤ 30 vetë paguajnë 50 % të tarifës normale të pastrimit dhe largimit të mbeturinave.

- Për njësinë administrative Velabisht, familjet në fshatrat Malinat, Bardhaj, Kodras, Veleshnje, Gjeroven, Palikesht, Drobonik përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave. Bizneset e këtyre fshatrave paguajnë 1/3 e tarifës.
- Për njësinë administrative Otllak, familjet në fshatrat Ullinjas, Bardhaj, Kodras, Veleshnje, Gjeroven, Palikesht, Drobonik përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave. Bizneset e këtyre fshatrave paguajnë 1/3 e tarifës.
- Për Bizneset e hapura, nga familjet e reja, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit dhe bizneset e drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, për të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë do të paguhet në 20% më ulët se tarifës normale.
- Për Familjet me një prind, me fëmijë deri në moshën 22 vjeç, që janë në vazhdimësi të arsimimit, për të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë do të paguhet në 30% më ulët se tarifës normale.

2. TARIFA E NDRICIMIT PUBLIK

Niveli i tarifës së ndricimit publik sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Njësia administrative		
	Berat	Roshnik	Otlak
	Lek/vit		
I. FAMILIARËT			
a. Për cdo familje	1 200	300	500
b. Me status invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetra-plegjike, ish të dënuar dhe të përndjekur politikë si dhe familje me një pjestarë	600	150	250
II. SUBJEKTE TË BIZNESIT TË VOGËL			
a. Për cdo subjekt të biznesit të vogël	4 200	600	
III. SUBJEKTE TË BIZNESIT TË MADH			
a. Transport pasagjerësh dhe mallrash	4 600	600	
b. Për cdo subjekt tjetër biznes i madh	6 000		
IV. INSTITUCIONE SHTETËRORE			
a. Për cdo institucion shtetëror	4 000		

- Tarifa e ndricimit publik për kategorinë I **“Familjarët”**, paguhet një herë në vit nga çdo familje.
- Tarifa e ndricimit publik për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”** dhe kategorinë III **“Subjektet të biznesit të madh”**, paguhet për cdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetet.
- Tarifa e ndricimit publik për kategorinë IV **“Institucione shtetërore”**, paguhet një herë në vit nga cdo institucion.
- Për njësinë administrative Roshnik, tarifa paguhet nga familjet dhe bizneset në fshatrat Roshnik, Vojnik dhe Karkanjok.

- Për njësinë administrative Berat, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndricimit publik për kategorinë I **“Familiarët”** ; është agjenti tatimor “Ujësjellës Kanalizime Berat – Kucovë Sh.a” për abonentët e vet. Për joabonentët e agjentit tatimor si dhe për vjeljen e detyrimeve të prapambetura të para vitit 2013 struktura e ngarkuar është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve.
- Për njësinë administrative Roshnik struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndricimit publik është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndricimit publik për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”**, kategorinë III **“Subjektet të biznesit të madh”** dhe për kategorinë IV **“Institucione shtetërore”**, është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve.

Afatet e pagesës

- Për kategorinë I **“Familiarët”**, për abonentët e agjentit tatimor “Ujësjellës Kanalizime Berat – Kucovë Sh.a, detyrimi vjetor paguhet me 12 këste mujorë.
- Për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”** dhe kategorinë III **“Subjektet të biznesit të madh”**, detyrimi paguhet me një këst të vetëm, i cili paguhet brenda datës 20 Prill.
- Për kategorinë IV **“Institucione shtetërore”** detyrimi paguhet me një këst të vetëm, i cili paguhet brenda datës 30 Qershor.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, pezullon veprimtarinë ose aplikon për cregjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet proporcionalisht duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose cregjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Lehtësirat tatimore

- Tarifëpaguesit e kategorisë I **“Familiarët”** dhe që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuar dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë, paguajnë 50 % të tarifës normale të ndricimit publik. Kjo zbatohet kur asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.
- Për njësinë administrative Berat, në zbatim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe Fondacionit Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim, të miratuar në parim me V.K.M nr. 918 datë 04.10.2013, tarifa e ndricimit që do mbledhet nga subjektet e biznesit që ushtrojnë aktivitet në Zonën për Zhvillimin e Biznesit (BID) do ti transferohet shoqatës së bizneseve të zonës BID.
- Për Bizneset e hapura, nga familjet e reja, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit dhe bizneset e drejuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit ,për të gjitha Njësitë Administrative ,kjo tarifë do të paguhet në 20% me ulët të tarifës normale.

- Për Familjet me një prind ,me fëmijë deri në moshën 22 vjec,që janë në vazhdimësi të arsimimit, per të gjitha Njësitë Administrative ,kjo tarifë do të paguhet në 30% me ulët të tarifës normale.

3. TARIFA E GJELBËRIMIT PUBLIK

Niveli i tarifës së gjelbërimit publik për njësinë administrative Berat, sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelë së mëposhtme :

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Lek/vit
I. FAMILIARËT	
a. Për cdo familje	500
b. Me status invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuar dhe të përndjekur politikë si dhe familje me një pjestarë	250
II. SUBJEKTE TË BIZNESIT TË VOGËL	
a. Për cdo subjekt të biznesit të vogël	2 600
III. SUBJEKTE TË BIZNESIT TË MADH	
a. Transport pasagjerësh dhe mallrash	3 000
b. Për cdo subjekt tjetër biznes i madh	3 500
IV. PËR INSTITUCIONET SHETËTORE	
a. Për cdo institucion shtetëror	2 000

- Tarifa e gjelbërimit publik për kategorinë I **“Familjarët”**, paguhet një herë në vit nga çdo familje.
- Tarifa e gjelbërimit publik për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”** dhe kategorinë III **“Subjektet të biznesit të madh”**, paguhet për cdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitet.
- Tarifa e gjelbërimit publik për kategorinë IV **“Institucione shtetërore”**, paguhet një herë në vit nga cdo institucion.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbërimit publik për kategorinë I **“Familjarët”** ; është agjenti tatimor “Ujësjiellës Kanalizime Berat – Kucovë Sh.a” për abonentët e vet. Për joabonentët e agjentit tatimor si dhe për vjeljen e detyrimeve të prapambetura të para vitit 2013 struktura e ngarkuar është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, ne Bashkine Berat.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbërimit publik për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”**, kategorinë III **“Subjektet të biznesit të madh”** dhe për kategorinë IV **“Institucione shtetërore”**, është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjev, ne Bashkine Berat.

Afatet e pageses

- Për kategorinë I **“Familjarët”**, për abonentët e agjentit tatimor “Ujësjiellës Kanalizime Berat – Kuçovë Sh.a, detyrimi vjetor paguhet me 12 këste mujorë.
- Për kategorinë II **“Subjekte të biznesit të vogël”** dhe kategorinë III **“Subjektet**

të biznesit të madh”, detyrimi paguhet me një këst të vetem, i cili paguhet brenda datës 20 Prill.

- Për kategorinë **IV “Institucione shtetërore”** detyrimi paguhet me një këst të vetëm, i cili paguhet brenda datës 30 Qershor.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brënda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, pezullon veprimtarinë ose aplikon për cregjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose cregjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Lehtesirat tatimore

- Tarifëpaguesit e kategorisë **I “Familiarët”** dhe që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, invalid para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë, paguajnë 50 % të tarifës normale të gjelbërimit publik. Kjo zbatohet kur asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.
- Në zbatim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe Fondacionit Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim, të miratuar në parim me V.K.M nr. 918 datë 04.10.2013, tarifa e gjelbërimit që do mbledhet nga subjektet e biznesit që ushtrojnë aktivitet në Zonën për Zhvillimin e Biznesit (BID) do të transferohet shoqatës së bizneseve të zonës BID.
- Për Bizneset e hapura, nga familjet e reja, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit dhe bizneset e drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, për të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë do të paguhet në 20% me ulët të tarifës normale.
- Për Familjet me një prind, me fëmijë deri në moshën 22 vjeç, që janë në vazhdimësi të arsimimit, për të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë do të paguhet në 30% me ulët të tarifës normale.

4. TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

Niveli i tarifës së parkimit të automjeteve sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otlak	Velabisht
I. Subjekte të transportit të udhëtarëve	Lek/vit				
a. Autovetura taksi deri në 5 vënde	6 000	600	600	2 500	2 400
b. Autovetura taksi 6 deri në 9 vënde		1 500	1 500		4 800

c. Autobusë 10 deri në 25 vënde		1 700	1 700	5 000	6 000
d. Autobusë 26 deri në 42 vënde					8 000
e. Autobusë mbi 42 vënde					10 000
II. Subjekte që kanë mjet në funksion të aktivitetit tregtar	Lek/vit				
a. Deri ne 1.5 Ton	2 000	1 700		1 700	1 700
b. 1.5 Ton deri 8 Ton	3 000				
c. 8 Ton deri 14 Ton	4 000	2 400		2 400	2 400
d. Mbi 14 Ton	5 000	3 000		3 000	3 000
III. Rezervim të vëndeve të parkimit	Lek/vit/vëndparkim				
a. Për çdo rezervim	12 000				
IV. Parkim në vend – parkime me pagesë	Lek/orë/vëndparkim				
a. Për çdo automjet i cili parkon në vendparkimet me pagesë në rrugë (me përjashtim të subjekteve të kategorisë 1, 2 dhe banorëve që kanë rezidencën në anë të rrugëve/shesheve ku shtrihet parkimi me pagesë)	50				
V. Abonime	Lek/vit/abonim				
a. Për çdo abonim	6 000				
VI. Mjete për punime	Lek/vit/mjet				
a. Motomjet për transport malli (motokarro)					1 000
b. Traktorë rrugor, karkaleca, fadroma, vinca					6 000

- Tarifa e parkimit të automjeteve për kategorinë I **“Subjekte të transportit të udhëtarëve”** dhe kategorinë II **“Subjekte që kanë mjet në funksion të aktivitetit tregtar”**, paguhet për çdo mjet që subjekti disponon. Vëndqëndrimet e automjeteve për subjektet e transportit të udhëtarëve përcaktohen nga Sektori i Shërbimeve Publike.
- Tarifa e parkimit të automjeteve për kategorinë II **“Subjekte që kanë mjet në funksion të aktivitetit tregtar”**, paguhet sipas tonazhit të mjetit (ngarkesës). Në rast se ngarkesa del në vlerë negative atëherë për efekt llogaritjeje përdoret vlera e kundërt (vlera pozitive).
- Tarifa e parkimit të automjeteve për kategorinë III **“Rezervim të vëndeve të parkimit”**, paguhet nga subjektet private dhe publike, të cilët rezervojnë vënde parkimi. Të gjithë subjektet që duan të rezervojnë vënd parkime duhet paraprakisht të marrin leje në Sektorin e Shërbimeve Publike.
- Tarifa e parkimit të automjeteve për kategorinë IV **“Parkim në vend – parkime me pagesë”**, paguhet nga çdo mjet që parkon në vend-parkimet me pagesë dhe për çdo orë parkimi, nga dita e hënë – e premte, ora 08⁰⁰ - 16⁰⁰, por mund të ketë përjashtime në përputhje me vendimet e nxjerra nga Bashkia Berat në lidhje me kufizimet e trafikut në zona/ditë/orare të caktuara.
- Rrugët dhe sheshet ku do të shtrihet parkimi me pagesë janë :

- Në anen e majte të “Shëtitore Osumi”, (segmenti ish Palma – Ufo”).
- Në rrugën “Antipatrea” (segmenti kryqezimi i gjykates – shkolla “22 Tetori”).
- Në rrugën “Antipatrea” (segmenti rruga “Fan Noli – rruga “Thoma Bello”).
- Përgjatë pjesës së dytë të Bulevardit “Republika” (segmenti banka “Raiffeisen” – rruga “Fan Noli”). - Sheshi tek ish Aghensia.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve pranë Bashkisë Berat.
- Struktura e Drejtorisë së Policisë Bashkiake merr gjithë masat e nevojshme për të garantuar vjeljen e tarifës së parkimit.

Afatet e pagesës

- Për kategorinë I **“Subjekte të transportit të udhëtarëve”** dhe kategorinë II **“Subjekte që kanë mjet në funksion të aktivitetit tregtar”**, paguhet detyrimi paguhet me një kësht të vetëm, i cili paguhet brenda datës 20 Prill.
- Për kategorinë III **“Rezervim të vëndeve të parkimit”** dhe kategorinë V **“Abonime”** detyrimi paguhet me një kësht të vetëm, i cili paguhet menjëherë pas konfirmimit të kërkesës së subjektit/personit.
- Për kategorinë IV **“Parkim në vend – parkime me pagesë”**, detyrimi paguhet në momentin e parkimit kundrejt biletës përkatëse.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues bën kërkesë, hap aktivitet, pezullon veprimtarinë ose aplikon për cregjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet proporcionalisht duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose cregjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

5. TARIFË TREGTIMI ME MJET

Niveli i tarifës së tregtimit me mjet për njësinë administrative Berat është 200 lek/mjet/ditë.

- Tarifa e tregtimit me mjet paguhet për cdo mjet që tregon në tregun e shitjes me shumicë të fruta-perimeve.
- Tarifa e tregtimit me mjet, paguhet për cdo mjet që tregon kundrejt prerjes së biletës përkatëse.
- Orari i tregtimit është cdo ditë deri në orën 8⁰⁰ dhe tregtimi me mjet ushtrohet vetëm në ambientet e lejuara.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së tregtimit me mjet është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, në Bashkinë Berat.

Afatet e pagesës

- Për tarifën e tregtimit me mjet, detyrimi paguhet në momentin e marrjes së biletës.

6. TARIFË E TREGTIMIT NË TREGUN INDUSTRIAL

Niveli i tarifës për tregtimin në tregun industrial për njësinë administrative Berat, sipas kategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORI	Lek/m ² /ditë
a. për njësitë e tregimit të tregut industrial me numrat Nr-89-103, 32-45, 61-75	13,99
b. Për njesite e tregimit të tregut industrial me numrat 31, 119-133, 149-163, 192-194, 204-206, 216-221, 229-234, 251-253, 263-265, 275-280, 288-293, 300.	21
c. Për njesine e tregimit te tregut industrial me numer 299	25,23
d. Për njësitë 254-262,195-203 dhe njësitë me numër 60,88,46,47	24,47
e. Për njësitë 146,147,76,77	25,48

- Baza e tarifës për tregtimin në tregun industrial është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte të ndryshme.
- Tarifa për tregtimin në tregun industrial llogaritet si detyrim ditor i taksapaguesit.
- Detyrimi i tarifës për llogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të Saj.
- Struktura e ngarkuar për vëlljen e tarifës është Drejtoria e Manaxhimit të Pronave dhe Strehimit.

Afatet e pagesës

Për tarifën për tregtimin tregun industrial pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit

7. TARIFË E ZËNIES SË HAPËSIRËS SË LIRË PUBLIKE

Niveli i tarifës së zënies së hapësirës së lirë publike sipas kategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

KATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otlak	Velabisht
	Lek/m ² /muaj				
I. Organizim i spektakleve ose panairove të ndryshme	100	70	70	70	70
II. Zënie hapësire publike për qëllime tregtimi në tregjet e lira publike					
III. Vendosje të tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësive					
IV. Të tjera					

- Baza e tarifës së zënies së hapësirës së lirë publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte të ndryshëm.

- Tarifa e zënies së hapësirës së lirë publike llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.
- Detyrimi i tarifës përlllogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.
- Për rastin e përdorimit të sipërfaqes publike me qëllim organizimin e spektakleve, panairove të ndryshme ose për vendosje të tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë, fillimisht subjekti duhet të paraqesë pranë Bashkisë Berat kërkesën për shfrytëzim të hapësirës publike.
- Lejohet që periudha e vendosjes së tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë, të jetë periudha pranverë, verë dhe vjeshtë (9 muaj/vit).
- Me përjashtim të subjekteve në zonën BID, lejohen të vendosen gjithsej deri në 6 tavolina, të cilat duhet të jenë të vendosura në një rresht, anës murit të lokalit (barit), pa penguar lëvizjen e kalimtareve.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së zënies së hapësirës së lirë publike është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve.
- Ndalohej zënia e hapësirave publike (trotuare, sheshe etj), të cilat nuk janë të miratuara nga Bashkia Berat.

Afatet e pagesës

- Për kategorinë I **“Organizim i spektakleve ose panairove të ndryshme”**, pagesa kryhet menjëherë me marjen e lejes përkatëse nga Bashkia Berat.
- Për kategorinë II **“Zënie hapësire publike për qëllime tregtimi në tregjet e lira publike”** dhe kategorinë IV **“Të tjera”**, pagesa do të bëhet brënda datës 30 të muajit përkatës.
- Për kategorinë III **“Vendosje të tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë”**, detyrimi paguhet me tre këste, në fillim të periudhave përkatëse.

8. TARIFË PËR LIÇENSË/CERTIFIKATË NË FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR

Niveli i tarifës për mjetet e transportit rrugor që pajisen me liçensë/certifikatë nga Bashkia Berat, sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Njësia	Tarifa/Lek Afati 5 vjet
I. TRANSPORT UDHËTARËSH		
a. Brënda vendit		
• Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Për linjë	40 000
- Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Për mjet	5 000
• Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për linjë	20 000
- Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për mjet	7 500
• Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut	Për linjë	75 000
- Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut	Për mjet	7 500
• Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut	Për linjë	75 000

- Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Për mjet	7 500
• Liçensë për transport udhëtarësh me taksi	Për mjet	20 000
II. TRANSPORT MALLRASH		
a. Brënda vendit		
• Liçensë për transport mallrash për të tretë dhe më qëra brënda vëndit	Për liçensë	40 000
- Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qëra brënda vëndit	Ton/kapac	100*
• Certifikatë për transport mallrash brënda vëndit për llogari të vet	Ton/kapac	100*
• Certifikatë për tërheqës	Për tërheqës	7 500
III. SHËRBIME TRANSPORTI		
a. Liçensë për agjensi transportit udhëtarësh dhe taksi brënda vendit	Për liçensë	15 000
b. Liçensë për agjensi transporti ndërkombëtar udhëtarësh	Për liçensë	40 000

- Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë.
- Për rastet e ndryshimeve në liçensë/certifikatë që kanë të bëjnë me elementët e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj paguhet 30% e vlefës së plotë
- * Për tarifat ku njësia është "Ton/kapac" vlefë e dalë nga llogaritja e ton/kapacitet do të shumëzohet me **pesë**.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për liçensë/certifikatë në fushën e transportit rrugor është Sektori i Shërbimeve Publike.

Afatet e pageses

☐ Per tarifën per liçensë/certifikate ne fushen e transportit rrugor, detyrimi paguhet menjehere me marrjen e liçensës/certifikates.

9. TARIFË REGJISTRIM VEPRIMTARIE BIZNESI

Niveli i tarifës së regjistrimit të veprimtarisë së biznesit sipas kategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË	Njësia administrative				
	Berat	Roshnik	Sinjë	Otllak	Velabisht
	Lek				
I. Ambulantë	2 000	1 000	1 000	1 000	1 000
II. Subjekte fizikë	10 000	5 000	5 000	5 000	5 000
III. Subjekte juridikë	15 000	7 500	7 500	7 500	7 500

- Tarifa e regjistrimit të veprimtarisë së biznesit paguhet **njëherë të vetme në** momentin e celjes së aktivitetit.
- Tarifa e regjistrimit të veprimtarisë së biznesit paguhet e plotë dhe jo proporcionalisht me kohën e çeljes të aktivitetit.

- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës regjistrim veprimtarie biznesi është Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, ne Bashkine Berat.

Lehtësirat tatimore

- Për bizneset që celin rishtas aktivitet në fushën e tregtimit/prodhimit të artikujve artizanale ose në fushën e turizmit familjar me seli në lagjet muzeale “Kala”, “Mangalem” dhe “Goricë”, detyrimi për tarifën e regjistrimit të veprimtarisë së biznesit, ulët me 30%.
- Në zbatim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe Fondacionit Shqiptarë – Amerikan për Zhvillim, të miratuar në parim me V.K.M nr. 918 datë 04.10.2013, tarifa e regjistrimit të veprimtarisë së biznesit që do mbledhet nga subjektet e biznesit që do celin rishtas aktivitet në Zonën për Zhvillimin e Biznesit (BID) do ti transferohet shoqatës së bizneseve te zonës BID.
- Për Bizneset e hapura, nga familjet e reja, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit dhe bizneset e drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit ,për të gjitha Njësitë Administrative ,kjo tarifë do të paguhet ne 20% me ulët te tarifës normale.
- Për Familjet me një prind ,me fëmijë deri në moshën 22 vjec,që janë në vazhdimësi të arsimit, per të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë do të paguhet në 30% me ulët të tarifës normale.

Afatet e pagesës

- Detyrimi tatimor për tarifën e regjistrimit të veprimtarisë së biznesit paguhet brënda datës 20 Prill.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brënda 30 ditëve nga data e regjistrimit.

9. TARIFA TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT

Niveli i tarifave të shërbimit të varrimit për njësinë administrative Berat, sipas kategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

KATEGORITË		Lekë
I.	Tarifë për varrimin e një personi deri në moshën 10 vjeç	9,939
II.	Tarifë për varrimin e një personi mbi moshën 10 vjeç	16,167
III.	Tarifë per varrim me cvarrim pa qivur mbi 10 vjeç	18,158
IV.	Tarifë per varrim me cvarrim me qivur mbi 10 vjeç	28,605
V.	Tarifë per varrim me cvarrim pa qivur nen 10 vjeç	11,968
VI.	Tarifë per varrim me cvarrim me qivur nen 10 vjeç	22,415

- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave të shërbimit të varrimit është Ndërmarrja e Gjellbërimit dhe Mirembajtjes se Varrezave Publike.

Afatet e pageses

- Detyrimi për tarifat e shërbimit të varrimit paguhet 10 ditë pas ndodhjes së ngjarjes (vdekjes/cvarrimit).

10. TARIFA TË TJERA TË NJËSISË ADMINISTRATIVE BERAT

Niveli i tarifave të tjera, sipas Drejtorive të ngarkuara për mbledhjen e këtyre të ardhurave përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Tarifa
I. Tarifa të Qendrës Ekonomike të Arsimit	
a. Kuotë ushqimore për nxënësit	Lek/muaj
☐ Me bursë të plotë	-
☐ Me gjysëm burse	3,182
☐ Me pagesë	6,365
b. Tarifë (kuotë) paradhënie	Lekë
☐ Për regjistrim në cerdhe	3 000
☐ Për regjistrim në kopësht	3 500
☐ Per nxënësit konviktorë	6 500
II. Tarifa të Sektorit të Shërbimeve Publike	
a. Tarifë për shërbim disefektimi	Lek /shërbim
☐ Në familje	500
☐ Në institucione jo në varësi të Bashkisë	1 000
III. Tarifa të Dejtorisë së Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit te Projekteve	
a. Tarifë akt – kontrolli nga specialistët e Drejtorisë për :	Lek/kontroll
☐ Piketimi i strukturës	3,000
☐ Përfundimi i themeleve	
☐ Përfundimi i kuotës ±0.00	
☐ Përfundimi i karabinasë	
☐ Përfundimi i fasadave dhe rifiniturat e strukturës	
☐ Përfundimi i sistemimit të jashtëm përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike	
b. Tarifë për ndërtim fasade objekti	Lek/m ²
☐ Për cdo m ²	30
c. Tarifë aplikimi për leje ndërtimi	Lek/aplikim
☐ Ndërtime të reja	10 000
☐ Rikonstruksione	5 000
d. Tarifa e shërbimit për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësive të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të trullall funksional të tyre, kur nuk posedon akt fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre	10 000 lekë
IV. Tarifa të Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani”	
a. Sallat e mbledhjeve/leksioneve	5 000
b. Salla e madhe (holli)	10 000
c. Për shfaqje të organizuara për cerdhet, kopshtet, shkollat	-
d. Për shfaqje/mbledhje të organizuara nga Bashkia Berat	-
V. Tarifa të Galerisë së Arteve “Edward Lear”	
a. Për ekspozita private të ndryshme	5 000
b. Për piktorët/talentet e rinj beratas	-
c. Për ekspozita të organizuara nga Bashkia Berat	-
VI. Tarifa të Bibliotekës “Vexhi Buharaja”	
a. Për mbledhje të organizuara në sallën e madhe (hollin)	4 000
b. Për mbledhje të organizuara në sallën e madhe nga Bashkia Berat	-
c. Hapje kartelexuesi të rregullt	Lek
☐ Për nxënësit e shkollave nëntëvjecare dhe të mesme	-
☐ Për kategori të tjera	50

- Për kategorinë I **“Tarifa të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit”**, të ardhurat nga tarifa (kuotë) paradhënie për regjistrim në cerdhe dhe kopësht janë të kthyeshme në funksion të detyrimeve që mund të lindin ndaj cerdhes dhe kopshtit në fund të periudhës së qëndrimit në cerdhe dhe kopësht.
- Të ardhurat për kategorinë II **“Tarifa të Sektorit të Shërbimeve Publike”** dhe për kategorinë III **“Tarifa të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve”** arkëtohen për cdo shërbim të kryer ndaj cdo subjekti/familjeje/institucioni jo në varësi të Bashkisë.
- **Për familjet në nevojë**, tarifa e shërbimit për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedon akte fitimi pronësie, kjo tarifë do të paguhet **ne masen 50% te tarifës normale**.
Baza materiale për kryerjen e shërbimit të disinfektimit duhet të sigurohet nga kërkuesi i shërbimit.
- Të ardhurat për kategorinë IV **“Tarifa të Pallatit të Kulturës Margarita Tutulani”**, kategorinë V **“Tarifa të Galerisë së Arteve Edward Lear”** dhe kategorinë VI **“Tarifa të Bibliotekës Vexhi Buharaja”** të ardhurat akëtohen në favor të Bashkisë Berat, në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë Bashkisë.
- Strukturat e ngarkuara për mbledhjen e tarifave të mësipërme janë Drejtoritë/institucionet e varësisë përkatëse.

Afatet e pagesës

Për kategorinë II **“Tarifa të Sektorit të Shërbimeve Publike ”** dhe për kategorinë III **“Tarifa të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve”**, të ardhurat arkëtohen për llogari të bashkisë menjëherë pas kryerjes së shërbimit.

11. TARIFA TË TJERA TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Tarifa
I. Tarifë për prerjen dhe mbledhjen e lëndës drusore për dru zjarri	500 lek/m³
II. Tarifë për therjen e bagëtive	Lek/krerë
a. Bagëti të trasha	100
b. Bagëti të imta	50
III. Tarifë ambienti	Lek/vit
a. Pulari	200 000
b. Mbarshtrim derrash, gjedh, thertore publike	20 000
c. Për aktivitet nxjerrje, prodhim, përpunim guri	
- Për biznes të vogël	15 000
- Për biznes të madh	30 000

IV. Tarifë për përdorimin e kullotave dhe livadheve	Lek/krerë
a. Të imta	100
b. Një thundrak dhe gjedh	800
V. Tarifë për bimë mjekësore	800 lek/Kv
VI. Tarifë për nxjerrje koci mare dhe shqopë	100 lek/Kv
VII. Tarifa të ujit	
a. Tarifë furnizimi me ujë të pijshëm	lek/m³
- Konsumatorë familjarë	50
- Institucione buxhetore dhe ente private	150
b. Tarifa largimi për ujërat e ndotura	lek/m³
- Konsumatorë familjarë	14.4
- Institucione buxhetore dhe ente private	24
c. Tarifa fikse	lek/muaj
- Konsumatorë familjarë	120
- Institucione buxhetore dhe ente private	240
d. Tarifë për pezullimin e faturimit (për abonentët pa matës)	120 lek/muaj
e. Kontratë furnizimi uji + kanalizime	lek
- Konsumatorë familjarë	9 600
- Institucione buxhetore dhe ente private	18 000
f. Tarifë për ndryshim emri	360 lek
g. Norma e përdorimit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujrave të ndotura për efekt pagese për përdorues pa matës	
- Familjarë	4.5 m ³ /person
- Subjekte biznesi	m ³ /subjekt
• Kafene, restorant, ushqim i shpejtë, piceri, bulmet, mish, peshk, ndërtim	30
• Furrë buke	12
• Ushqimore, tregti me pakicë/shumicë.	10
• Shërbime, profesione të lira etj...	5

- Për kategorinë I **“Tarifë për prerjen dhe mbledhjen e lëndës drusore për dru zjarri”**, të ardhurat arkëtohen kundrejt sasisë përkatëse të druve të prerë. Lejohet që çdo familje të presë sasinë deri në 5 m³ dru.
- Për kategorinë VII **“Tarifa të ujit ”**, pika b **“Tarifa largimi për ujërat e ndotura”** familjet dhe bizneset që përdorin gropa septike nuk e paguajnë këtë tarifë.
- Për kategorinë VII **“Tarifa të ujit ”**, norma e faturimit të ujrave të ndotura për efekt pagese për përdorues pa matës është e barabartë me normën e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdorues pa matës

12. TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV

Niveli i tarifave të shërbimit administrativ për **Njësinë Administrative Berat**, sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Tarifa
I. Tërheqje dokumentash dhe njehsim me originalin nga arkiva	Lek/copë
a. Për cdo dokument (Vendime të K.B, K.RR.T, ekstrakt harte nga arkiva teknike në formatin A4/A3, etj..)	1 000
II. Dhënie vërtetimi (që jepen edhe nga njësitë e tjera administrative)	Lek /copë
a. I thjeshtë	100
b. Të tjerë (për pjesmarje në tender, për investime të Bashkisë zbatuar nga shoqëritë ndërtuese, për pagën neto mesatare, për bazën e vlerësueshme etj..)	500
III. Autorizim për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre	Lek/autorizim
a. Për dhënien dhe përsëritjen e licensës për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet dhe vajrave	2 000 000
b. Për dhënien dhe përsëritjen e licensës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë	200 000
IV. Leje ushtrim aktiviteti për subjektet, aktivitetit i të cilave është burim zhurme	Lek/copë
a. Për mjediset e hapura	5 000
b. Për mjediset e mbyllura	7 000
V. Dhënie dokumenti nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve	Lek/copë
a. Fotokopje të njehsuara të hartave të Beratit	5 000
b. Dokument për Z.V.R.P.P me kërkesën e qytetarit	1 000
c. Fotokopje studimi urbanistik në formularin A1	10 000
d. Ekstrakt i P.V.D (Planit Vendor të Detajuar)	15 000
e. Dhënie e lejës së shfrytëzimit (përdorimit)	Lek/kat
- Për lokale dhe banesa kolektive	15 000
- Për banesa individuale	10 000
VI. Dhënie certifikate veterinare	Lek/copë
- Për cdo certifikatë	100

- Këto tarifa paguhen për cdo dokument të leshuar nga cdo Drejtori/Rajon.
- Vërtetime të thjeshta konsiderohen vërtetimet për:
Pagë, qenie banor/ish banor lagje i qytetit, verifikim personi, persona që kane/s'kanë tokë , vërtetim për kufijt, leje ndërtimi, blerje trualli, leje sheshi ndërtimi, të pastrehë etj...
- Për kategorinë **III "Autorizim për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre"**, autorizimi jepet për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë ripërsëritje.
- Për kategorinë **IV "Leje ushtrim aktiviteti për subjektet aktiviteti i të cilëve është burim zhurme"**, leja jepet për një periudhë 1 vjecare me të drejtë ripërsëritje.
 - Për mjediset e hapura orari i lejimit të veprimtarive, për ditët e premte dhe të shtunë, të jetë nga ora 19⁰⁰ deri në orën 24⁰⁰, ndërsa për ditët e tjera të javës të jetë nga ora 19⁰⁰ deri në orën 23⁰⁰, sipas normave të lejuara të zhurmës.

- Për mjediset e mbyllura, veprimtaria lejohet pa kufizime orari, duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave të shërbimit administrative janë:
 - Për kategorinë I **“Tërheqje dokumentash dhe njehsim me origjinalin nga arkiva”**, është “Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun” si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve, ne Bashkinë Berat.
 - Për kategorinë II **“Lëshim vërtetimi”**, janë gjithë Drejtoritë, njësite administrative dhe Rajonet e Bashkisë të cilët japin vërtetimet përkatëse.
 - Për kategorinë III **“Licensë për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”**, dhe për kategorinë IV **“Leje ushtrim aktiviteti për subjektet aktivitetit i të cilëve shkakton zhurmë”** është Drejtoria e Bujqësisë Veterinarisë Mjedisit dhe Kadastrës. Për kategorinë V **“Dhënie dokumenti nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve”** është Drejtoria e Planifikimit të Territorit Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve
 - Për kategorinë VI **“Dhënie certifikate veterinare”** është Drejtoria e Transportit Emergjencave dhe Shërbimeve.

Afatet e pagesës

- ☐ Tarifat e shërbimit administrativ paguhen në bankë/arkë pas leshimit të akt-detyrimit nga Drejtoria/Rajoni/Zyra që perkatese.

Baza Ligjore

Ligji Nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”.

Ligji Nr. 9632 dt. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime, dhe Udhëzimi 32 dt. 31.12.2013 në zbatim të tij.

Ligji Nr. 9920 dt 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe Udhëzimi Nr. 24 dt. 02.09.2008 në zbatim të tij, me ndryshime.

Vendimi i Këshillit Bashkiak

Për çdo informacion plotësues, mos hezitoni të drejtoheni në:

Drejtorinë e Taksave, Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve ne Bashkinë Berat ose

<http://www.berat.gov.al/>



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

Kjo broshurë u bë e mundur me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Ajo u përgatit nga Projekti i USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore.